REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN

DEÇANI

Kuvendi i Komunës së Deçanit duke u bazuar në nenin 12.2 shkronja (b, si dhe nenin 40.1 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe nenit 37 të Statutit të Komunës 01. Nr. IX-5 të dt. 31. 10. 2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt. 31.01.2022, miraton këtë:

R R E G U L L O R E

PËR

P U N Ë N E K U V E N D I T T Ë K O M U N Ë S

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

QËLLIMI

NENI 1

1. Me këtë Rregullore përcaktohen rregullat e procedurave që duhet zbatuar për mbajtjen e mbledhjes së parë inauguruese, mbledhjeve të rregullta, mbledhjeve të jashtëzakonshme, mbledhjeve publike, mbledhjeve solemne dhe mbledhjeve urgjente të Kuvendit, si dhe rregullat e debatimit e të votimit, dhe rregullat e sjelljeve të pjesëmarrësve në mbledhje.

2. Të gjitha dispozitat e kësaj Rregulloreje që i dedikohen punës së mbledhjeve të Kuvendit ngjashëm do të aplikohen edhe në punën e Komiteteve, Nënkomiteteve, Komisioneve dhe grupeve punuese etj. Përveç nëse kërkohet ndryshe me dispozita të veçanta ligjore .

3. Në mbledhjet e Kuvendit, nuk mund të shqyrtohet dhe të vendosët për asnjë çështje që nuk është në kompetencën e Kuvendit me akte juridike.

PËRKUFIZIMET

NENI 2

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim.

a) **"Ligj"**, nënkupton Ligjin për vetëqeverisjen lokal (nr 03/L-040):

b) **"Statut"**, nënkupton aktin më të lartë juridik të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Deçanit:

c) **"Kuvendi i Komunës"**, nënkupton organi me i lartë i Komunës së Deçanit, që përbëhet prej anëtarëve të tij të zgjedhur.

d) **"Komitet"**, nënkupton Komitetet e përhershme, Komitetet konsultative dhe Komitetet tjera, të themeluara nga Kuvendi i Komunës në pajtim me Ligjin, Statutin e Komunës dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit.

e) **"Komision",** nënkupton komisionet apo trupat tjera punuese të përhershme apo të përkohshme të themeluara sipas nevojës nga Kuvendi i Komunës në përputhshmëri me Statutin.

f) **"Anëtari/ja e Kuvendit**", nënkupton anëtarin/ën e Kuvendit, të zgjedhur drejtpërdrejt nga vota e qytetarit, në pajtim me Ligjin në fuqi për zgjedhjet lokale:

g) **"Kryetar i Komunës'**, nënkupton kryetarin e zgjedhur drejtpërdrejt nga vota e qytetarit, në pajtim me ligjin në fuqi për zgjedhjet lokale.

h) **"Kryesues i Kuvendit",** nënkupton kryesuesin e zgjedhur nga anëtarët e Kuvendit të Komunës së Deçanit.

i) **"Grupi i anëtarëve',** nënkupton një grup që përbëhet prej se paku dy (2) anëtarëve të Kuvendit që udhëhiqet nga Shefi/ja i/e grupit i/e emëruar nga vet anëtarët e Kuvendit.

j) **"Kryesues i Komitetit"**– nënkupton kryesuesin e zgjedhur nga ana e anëtarëve të komitetit, përveç kryesuesit të Komitetit për Politik dhe Financa të cilin me automatizëm e udhëheq kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

k) **"Drejtor",** nënkupton person zyrtar, i emëruar politik nga Kryetari i Komunës që udhëheq një drejtori të caktuar përgjatë mandatit të njëjtë me kryetarin e Komunës.

l)"Sekretaria e Kuvendit" – nënkupton zyrën për ofrimin e shërbimeve profesionale për anëtarët e Kuvendit, Komiteteve, Komisioneve dhe trupave tjerë të themeluar nga Kuvendi i Komunës.

m)"Votim i shumicës"- do të thotë votim për të cilin kërkohet miratimi i më shumë se gjysmës së anëtarëve të pranishëm dhe votim në mbledhjen në të cilën shqyrtohet propozimi. Ky është një mekanizëm përmes të cilit duhet të merren vendimet e Kuvendit të Komunës;

n)"Shumica prej dy të tretave (2/3)"- do të thotë votimi që kërkon miratimin e 2/3 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës (në rastet që i parasheh ligji dhe Statuti i Komunës).

PJESËMARRJA NË MBLEDHJEN E KUVENDIT

NENI 3

1. Shërbimi Profesional për punë të Kuvendit duhet të siguroj kushte të nevojshme për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit:
2. Kryesuesi dhe anëtaret e kuvendit duhet të pajisen me adresa elektronike, të cilat duhet të përdoren për komunikim zyrtar. Adresa elektronike zyrtare duhet të publikohen në faqen zyrtare të komunës:
3. Anëtarët e kuvendit duhet të pajisen me kartelë identifikimi. Pajisjen me kartelë identifikimi e kryen organi kompetent i administratës së komunës:
4. Kuvendi i Komunës, përkatësisht Administrata komunale do t'ua lehtësoj pjesëmarrjen e anëtarëve të kuvendit me aftësi të kufizuara dhe siguroj çfarëdo ndihme teknike për këtë qëllim:
5. Secili anëtar/e i kuvendit është i obliguar të marrë pjesë në mbledhje të kuvendit, dhe duhet të regjistrohet me emër e mbiemër e të nënshkruhet në regjistrin e dedikuar për këtë qellim:
6. Në rast të pamundësisë së ardhjes në mbledhje, anëtari/ja i/e kuvendit obligohet që pa vonesë të njoftoj Kryesuesin e Kuvendit për çdo mungesë (me ose pa arsye) në mbledhje, dhe duhet të shënohet në procesverbal:

MBLEDHJA E PARË INAUGURUESE E KUVENDIT TË KOMUNËS

Neni 4

1. Me qellim të konstituimit të Kuvendit Komunal, ftohet Mbledhja e parë inauguruese e anëtarëve të zgjedhur për Kuvend, e cila duhet patjetër të mbahet brenda 15 ditësh pas çertifikimit zyrtar të rezultateve të zgjedhjeve.

2. Para takimit inaugurues të Kuvendit Komunal, të gjithë anëtarët e zgjedhur të Kuvendit, duhet të regjistrojnë deklaratën e pasurisë financiare në një regjistër publik i mbajtur nga një zyrtar i autorizuar i Komunës.

3. Mbledhja e parë inauguruese e Kuvendit thirret nga Kryetari i Ri i Komunës (nëse është zgjedhur) brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e çertifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

   Nëse Kryetari dështon të thërrasë mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Komunës, brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, mbledhja e parë inauguruese e Kuvendit të Komunës, mund të thirrët nga anëtari më i vjetër i zgjedhur i Kuvendit brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data kur është dashur ta thirr Kryetari.

   Nëse as anëtari më i vjetër i Kuvendit nuk e thërret mbledhjen inauguruese sipas detyrës së tij nga paragrafi 2 i këtij neni, atëherë mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës, mund të caktohet me iniciativë të shumicës së anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit të ri.

4. Mbledhjen inauguruese e kryeson anëtari më i vjetër i Kuvendit, derisa të japin betimin (deklaratën solemne), anëtarët e zgjedhur të Kuvendit dhe të zgjidhet Kryesuesi i Kuvendit të ri.

5. Mandati i çdo anëtari të Kuvendit të Komunës verifikohet nga Komisioni për Verifikimin e mandateve, i cili themelohet nga Kuvendi i Komunës para nënshkrimit të pranimit të mandatit nga secili anëtar.

6. Kryesuesi i fton të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës, që ta japin dhe nënshkruajnë Betimin (Deklaratën solemne) me tekstin si në vijim :

   "Betohem (deklaroi solemnisht) se do t'i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtar/e i /e Kuvendit të Komunës së Deçanit, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë".

7. Kryetari i zgjedhur i Komunës e japë betimin ose deklaratën solemne para anëtarëve të Kuvendit të komunës. Teksti i betimit është si në vijim:

   "Betohem (ose deklaroi solemnisht) që do t'i kryej detyrat e mia dhe do t'i ushtroj kompetencat e mia si Kryetar i Komunës së Deçanit,me nderë besnikëri , në mënyrë të paanshme,me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që t'i siguroj kushtet për një jetë të qetë për të gjithë".

8. Anëtarët e Kuvendit të komunës, të cilët nuk e nënshkruajnë betimin ose mandatin në pajtim me paragrafin 1 të kësaj Rregulloreje, brenda një muaji pas çertifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, pushojnë së qeni anëtar.

ZGJEDHJA E KRYESUESIT TË KUVENDIT

NENI 5

1. Para se të shkohet në propozimin e kandidatëve për Kryesues të Kuvendit, propozohet dhe votohet përbërja e Komisionit për votim prej tre (3) anëtarëve, nëse nuk aprovohet ndonjë propozim ndryshe.

2. Kryesuesi i seancës inauguruese, i fton anëtarët e subjekteve politike që participojnë në Kuvendin e Komunës që të paraqesin kandidaturat e veta për Kryesues të Kuvendit.

3. Pasi të merën kandidaturat e propozuara, Kryesuesi kërkon 10 (dhjetë) minuta pauzë, me qellim që komisioni votues të përgatitë fletëvotimet.

4. Kryesuesi i Kuvendit e fton Komisionin votues që të fillon me procedurën e votimit me ç'rast njeri prej anëtarëve të komisionit i fton një nga një anëtarët që të marinë fletëvotimin dhe të votojnë. Pas përfundimit të votimit, votat numërohen publikisht dhe rezultatin e raporton njëri nga anëtarët e Komisionit.

5. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit bëhet me votim të fshehtë dhe është i zgjedhur ai kandidat i cili ka fituar së paku 51% të votave të anëtarëve prezent. Nëse asnjeri prej

kandidatëve nuk fiton në votimin e parë, atëherë në të njëjtën seancë apo në një seancë me datë tjetër, por që konsiderohet seancë vazhduese e të parës, përsëritet votimi për dy kandidatët që në rundin e parë të votimit kanë fituar numër më të madh të votave. Në rundin e dytë është i zgjedhur ai kandidat që ka fituar më shumë së gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të prezent nga anëtarët e zgjedhur.

UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR.2009/01 "PËR PROCEDURËN E ZGJEDHJES DHE PËRGJEGJËSITË E KRYESUESIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS" NENI 3 PIKA 4 DHE 5.

6. Nëse edhe pas votimit të dytë asnjëri nga kandidatët nuk ka fituar shumicën e kërkuar si në pikën 3 të këtij Udhëzimi atëherë shkohet në votimin e tretë. Në votimin e tretë kryesusi i Kuvendit të Komunës zgjedhet kandidati, i cili merr më shumë se gjysmën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë, për propozimin në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

7. Nëse edhe pas votimit të tretë nuk zgjedhet Kryesusi i Kuvendit të Komunës, atëherë i tërë procesi për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Komunës përsëritet.

8. Derisa të zgjidhet Kryesuesi, mbledhjet do ti kryesoi anëtari më i vjetër i Kuvendit. Nëse zgjidhet Kryesuesi i ri i Kuvendit Komunal, ai menjëherë do ta merr kryesimin e mbledhjes për shqyrtimin e rendit të ditës për çështjet e mbetura.

KOURUMI DHE MBLEDHJET E KUVENDIT

NENI 6

1) Për të gjitha mbledhjet e Kuvendit dhe Komitetet e tij, kuorumi përbëhet nga më shumë se gjysma e anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit Komunal.

2) Verifikimi i Kuorumit duhet të behët në fillim të çdo seance, e po ashtu edhe para marrjes së ndonjë vendimi nëse konsiderohet së gjatë punimeve të seancës janë krijuar mungesa të anëtarëve që në fillim kanë qenë prezent.

3) Nëse mungon kuorumi, mbajtja e seancës mund të shtyhet për të njëjtën ditë më vonë me obligim që të sigurohet kuorumi ose mund shtyhet për një datë tjetër.

4) Mbledhjet e Kuvendit i thirr dhe i kryeson Kryesuesi i Kuvendit.

5) Mbledhjet e Kuvendit mund të thirrën edhe me kërkesën e një të tretës (1/3) së të gjithë anëtarëve të zgjedhur,ose me kërkesën e një Komiteti të Kuvendit.

6) Nëse mungon Kryesuesi i Kuvendit, mbledhjet i kryeson anëtari të cilin e autorizon vet kryesuesi.

7) Anëtarëve të Kuvendit u dërgohet ftesa obligativisht së paku shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së Mbledhjes së rregullt të Kuvendit, me materiale për rendin e ditës, dhe përcaktimin e vendit dhe kohës së mbajtjes së mbledhjes.

8) Rëndi i ditës për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, caktohet nga Kryesuesi i Kuvendit në konsultim me Kryetarin e Komunës.

9) Anëtari apo anëtarët e Kuvendit ose edhe Kryesuesi i Kuvendit në marrëveshje me Kryetarin e Komunës, mund të kërkojnë shtimin e një pike të rendit të ditës , nëse çështja që kërkohet të përfshihet në rend të ditës së asaj mbledhje, është me interes të veçantë për Komunën. Kërkesa e tillë qitet në votim të veçantë dhe e njëjta mund të aprovohet apo refuzohet.

10) Nëse çështja e propozuar nga pika 8, është e rëndësisë së tillë, për të cilën paraprakisht duhet të konsultohet dhe të merret pëlqimi edhe nga Komiteti për Politikë dhe Financa, atëherë Kryesuesi i Kuvendit me pëlqimin e anëtarëve, mund të ndërpresë përkohësisht mbledhjen e Kuvendit, me qellim të konsultimit dhe marrjes së qëndrimit apo vendimit nga Komiteti për Politikë dhe Financa për të cilën gjë, në vazhdim të mbledhjes do të njoftohen anëtarët pjesëmarrës në mbledhjen e Kuvendit.

TAKIMET E HAPURA DHE PUBLIKE TË KUVENDIT TË KOMUNES

NENI 7

1. Përveç ftesës (dhe materialit) që u dërgohet anëtarëve të Kuvendit për mbledhje, në të njëjtën kohë do të behën edhe njoftime publike (i ftesës) për këto mbledhje meqë takimet e Kuvendit dhe Komiteteve si dhe Komisioneve të tij janë të hapura për publikun.

NENI 8

1. Kuvendi i Komunës apo Komiteti, me votën e shumicës së anëtarëve, mund të vendosë për përjashtimin e publikut apo edhe të medieve, nga një pjesë apo nga i terë takimi, në rastet kur në shqyrtim janë çështjet që dëmtojnë rëndë interesin e përgjithshëm publik apo në rastet tjera të përcaktuara me ligj dhe Statutin e Komunës. Në rastet e tilla Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e njofton publikun me arsyetimin e vendimit të tillë.

2. Mbledhjet publike të cilat u dedikohen vetëm publikut, mbahen së paku dy (2) herë në vit në një sallë e cila është e mjaftueshme për pjesëmarrësit e interesuar.

3. Mbledhjet publike i kryeson Kryesuesi i Kuvendit ose i autorizuari i tij.

4. Kryesuesi i mbledhjes publike ka autoritetin që të propozoi procedurat të cilat duhet të miratohen në mbledhje, e që kanë të bëjë me udhëheqjen me mbledhjen publike, në mënyrë që të mos lejohet diskutimi i çfarëdo çështjeje që nuk ka të bëjë me funksionet dhe përgjegjësitë e Komunës.

5. Për pyetjet e parashtruara në mbledhjet publike e për të cilat nuk mund të jepet përgjigja gjatë mbledhjes, parashtruesit të pyetjes i behët me dije së Organi kompetent ose personi përgjegjës, ka obligim që brenda 30 ditëve ta japi përgjigjën me shkrim.

6. Në mbledhje publike mbahet procesverbali i cili do t'i prezantohet për shqyrtim Komitetit për Politikë dhe Financa në mbledhjen e parë të radhës pas mbajtjes së mbledhjes publike.

NENI 9

1. Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit dhe të komiteteve, mbahet procesverbali i cili do të prezantohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e radhës. Procesverbali duhet të përmbajë emrat e anëtarëve të pranishëm dhe anëtarëve tjerë të ftuar pjesëmarrës në mbledhje, rendin e ditës, esencën e diskutimit, rezultatin numerik të votimit dhe titujt e materialeve dhe propozimeve të miratuara apo të refuzuara.
2. Nëse kërkohet, në procesverbal duhet të shënohet edhe fakti së si ka votuar secili anëtar. Gjatë mbajtjes së mbledhjes së Kuvendit me vendim të veçantë Kuvendi ka të drejtë të vendosë që mbledhja të përcillet edhe në transkript përveç procesverbalit.
3. Anëtari i Kuvendit të Komunës mund të dorëzoi vërejtje me shkrim për çështjet që janë në rend të ditës, të cilat i bashkëngjitën procesverbalit.

NENI 10

1. Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve, kanë të drejta të plota dhe mundësi të barabarta të marrin pjesë në punimet e Kuvendit dhe të kërkojnë informacione nga Kryetari për çështje të ndryshme me interes për komunën.

NENI 11

1. Në seancën e fundit të vitit, Kuvendi aprovon Planin e vet të punës për vitin që pason.

MBLEDHJET E JASHTËZAKONSHME DHE SOLEMNE TË KUVENDIT

NENI 12

1. Takimi i jashtëzakonshëm i Kuvendit të Komunës, caktohet me kërkesën e bërë me shkrim nga më së paku një e treta (1/3) e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të

Kuvendit apo me kërkesë të Kryetarit të Komunës në të cilën kërkesë përcaktohet edhe rendi i ditës . Pikat e caktuara të rendit të ditës për mbledhje të jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes.

2. Takimi i jashtëzakonshëm nuk mund të mbahet nëse anëtarët e Kuvendit dhe publiku nuk janë njoftuar së paku tri (3) ditë pune para datës së mbajtjes së takimit.

   Për mbajtjen e mbledhjeve të jashtëzakonshme, zhvillohen të njëjtat procedura të njoftimit dhe çështjet tjera si për mbledhjet e rregullta.

   Procedurat e lartpërmendura nuk zbatohen për takimet që thirrën për shkak të rrethanave urgjente.

3. Kuvendi i Komunës mundë të mbajë mbledhje solemne në rastet e shënimit të datave, përvjetorëve dhe ngjarjeve të rëndësishme të karakterit komunal dhe shtetërorë.

   Mbledhjet solemne i thërret Kryesuesi i Kuvendit në bashkëpunim me kryetarin e Komunës.

RREGULLAT E DEBATIMIT NË MBLEDHJET E KUVENDIT

NENI 13

1. Në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, nuk mund të debatohet dhe vendoset për asnjë çështje e cila paraprakisht nuk është përcaktuar, respektivisht nuk është aprovuar që të jetë në rend dite.

2. Nëse propozohet ndryshimi i ndonjë çështjeje të përcaktuar për shqyrtim, atëherë propozimi i dytë i aprovuar e zë vendin e të parit.

3. Kryesuesi i mbledhjes vendos për renditjen e atyre anëtarëve të Kuvendit që e kanë kërkuar fjalën për diskutim.

Pasi të merr fjalën, anëtarët i drejtohen Kryesuesit të mbledhjes dhe gjatë diskutimit duhet t'i përmbahet çështjes aktuale që është parashtruar në pikën konkrete të rendit të ditës.

4. Përfaqësuesit e grupeve në Kuvend, në fillim të çdo pike diskutimi mund të diskutojnë për atë çështje, në kohëzgjatje prej 7 min.

5. Çdo anëtarë i Kuvendit, ka të drejtë të diskutoj për një pikë të rendit të ditës vetëm një herë në kohëzgjatje prej pesë (5) minutash.

6. Anëtarët e Kuvendit mund të replikojnë vetëm njëherë me njeri - tjetrin për mendimin e shprehur, në raste të apostrofimit me emër, nga parafolësi, gjatë diskutimit për çështje të caktuar.
   Replika zgjat deri në një (1) minutë. Replika duhet të jetë korrekte, jo fyese.

7. Kryetari i Komunës, ose përfaqësuesi i tij nga Ekzekutivi, ka të drejtë të kërkoj nga Kryesuesi i Kuvendit, të marrë fjalën pas përfundimit të fjalës së çdo diskutuesi/se për të dhënë shpjegimet për çështjet që diskutohen.

8. Nuk mund të kalohet për debatim në pikën tjetër të rendit të punës, para së të përfundon shqyrtimi dhe vendosja për pikën rreth të cilës është hapë debati.

9. Kur Kryesuesi apo anëtari e merr fjalën për debatim, anëtarët tjerë qëndrojnë ulur dhe nuk u lejohet që të ndërhyjnë në debatimin e tjetrit pa e marrë fjalën sipas radhës nga Kryesuesi i mbledhjes.
   Kryesuesi mund të kërkoi që anëtarët e paraqitur për debat, fjalën e vet ta prezantojnë në foltore.

10. Kryesuesi duhet të respektoi parimin e barabarësisë në mënyrë që të gjithë anëtarëve të Kuvendit t'iu mundësoi pjesëmarrje të barabartë në diskutim.

11. Kryesues i Kuvendit dhe përfaqësuesit e grupeve të anëtarëve, mund të kërkojnë pauzë për një kohë të caktuar të seancës, për të cilën vendosin Kryesuesi dhe Anëtaret e Kuvendit.

12. Qytetarëve që marrin pjesë në mbledhjet e rregullta ose në mbledhjet publike të Kuvendit, mund t'iu lejohet nga Kryesuesi i Kuvendit diskutimi por jo edhe votimi.

PROCEDURAT E VOTIMIT NE MBLEDHJE

NENI 14

1. Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit dhe Komiteteve vendimet merren përmes votimit në këto mënyra:

   a) votimi i hapur bëhet me ngritjen e dorës:
   b) Votim i fshehtë bëhet me thirrjen e secilit anëtar/e të kuvendit për hedhjen e votës në vendin e caktuar për votim:
   c) Votimi elektronik
   d) Abstenimet:

2. Anëtarët e Kuvendit dhe komiteteve duke përfshirë edhe Kryesuesin e mbledhjes, me rastin e votimit kanë vetëm një votë, përjashtimisht, kur me rastin e votimit për një çështje votat janë të barabarta në numër **"PËR"** ose **"KUNDER",** Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit e ka të drejtën edhe të një vote shtesë.

3. Kuvendi i Komunës dhe komitetet e tij, vendimet i marrin me vota të hapura të shumicës së anëtarëve prezent, përveç nëse kërkohet ndryshe me Ligj apo Statutin e Komunës.

4. Abstenimet në votim nuk merren parasysh në rezultatin e votimit,por regjistrohen me qellim të verifikimit të ekzistimit të kuorumit.

5. Secili anëtar ka të drejt të kërkoi veçimin e votimit apo abstenimit dhe kjo të shënohet në procesverbal.

6. Anëtari i Kuvendit nuk mund të këtë përgjegjësi apo pasoja për votën e dhënë apo abstenim.

THEMELIMI DHE KOMPENSIMI I KOMITETEVE TË PËRHERSHME DHE KOMISIONEVE TË KUVENDIT TË KOMUNES

NENI 15

1. Kuvendi i Komunës në bazë të nevojës mund të krijoj trupa punues, komisione të caktuara, të cilat kanë mandate për një çështje dhe për një afat kohorë.
2. Numri i Anëtarëve të Komisioneve, duhet të jetë numër tek, 3, 5, 7... dhe zgjedhën duke e respektuar përqindjen e përfaqësimit të subjekteve në Kuvend.
3. Në Komisioni, për çështje të caktuara mund të propozohen edhe ekspert të jashtëm, nëse për këtë ka pajtueshmëri dhe aprovim nga Kuvendi.
4. Komisionet janë të obliguar t'i raportojnë Kuvendit për punën dhe rezultatin e tyre.
5. Mbledhjen e parë të Komisionit e thërret Kryesuesi i Kuvendit, ose me autorizimin e tij e thërret, Sekretari/ja i/e Kuvendit, apo njeri nga Anëtarët e Komisionit të cilin e autorizon Kryesuesi.
6. Kryesuesi i Komisionit zgjedhjet nga anëtarët e Komisionit, në takimin e parë, me përjashtim, kur pjesë e një Komisioni është Kryesuesi i Kuvendit, ai e kryeson me automatizëm.
7. Kompensimi i anëtarëve të komiteteve të obligueshme për pjesëmarrje në seancë caktohet me Udhëzim Administrativë për kompensimin e stafit politik në Komuna të miratuar nga MPL.
8. Anëtarët e komiteteve të obligueshme nuk mund të kompensohen më shumë se për 12 seanca brenda vitit.
9. Kompensimi i anëtarëve të komisioneve të themeluara nga Kuvendi i Komunës për punën e tyre, bëhet nga Buxheti i Komunës si vijon:
   a) shuma e kompensimit duhet të jetë në proporcion me shumën e mëditjeve të anëtarëve të komiteteve te përhershme KPF dhe KK
   b) anëtarët e komisioneve apo komiteteve ad hoc, nuk mund të paguhen më shumë se gjashtë (6) mbledhje të cilat mbahen brenda vitit.

NENI 16

1. Sjellje jo të mira të shkaktuara nga anëtarët e Kuvendit gjatë mbledhjes konsiderohen: Çdo sjellje jo e mirë që bie ndesh me normat dhe parimet etike të sjelljes:

   - Pengimi në procesin e punimeve të mbledhjes,
   - Mos respektimi i vërejtjeve dhe rekomandimeve të kryesuesit,veprimet dhe sjelljet në mënyrë ofenduese, etj.

2. Nëse anëtari vazhdon me sjelljet e tilla, Kryesuesi mund të ndërmerr masat në vijim:

   - Propozon që anëtari të mos dëgjohet dhe i ndalohet diskutimi në atë mbledhje,
   - Nëse propozimi qitet në votim, anëtarit i ndalohet votimi në atë mbledhje,
   - Jep urdhër që anëtari të tërhiqet tërësisht nga mbledhja ose pjesa e mbledhjes, përveç nëse ka votim,
   - E shtynë mbledhjen për një orë ose gjer në terminin e ardhshëm të caktuar.

NENI 17

1. Nëse pjesëtari i publikut pengon mbledhjen, kryesuesi do t'ia tërheq vërejtjen.
2. Nëse ai/ajo vazhdon, kryesuesi do të ndërmerr këto masa:
   - udhëzon anëtarin e publikut që të tërhiqet pjesërisht nga mbledhja,
   - jep urdhër që të largohet përfundimisht nga mbledhja,
   - shtynë mbledhjen për një termin tjetër.

NENI 18

1. Nëse pjesëmarrësit në mbledhje shkaktojnë çrregullime të mëdha, Kryesuesi mund të urdhëroi që të gjithë ta lirojnë sallën, ta shtyjë mbledhjen për një orë ose kohë më të gjatë apo të mbahet në një vend tjetër .

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

NENI 19

1. Në rast të kolizionit të dispozitave të kësaj Rregulloreje me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale apo të Statutit të Komunës, atëherë aplikohen dispozitat e këtyre të fundit.

NENI 20

1. Për çështjet të cilat nuk janë të përcaktuara me këtë Rregullore, do të aplikohen drejtpërdrejt dispozitat ligjore dhe të Statutit të Komunës.

SHFUQIZIMI

NENI 21

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja e Punës së Kuvendit, 01 Nr. I-3 të dt. 31.01.2013.

NENI 22

1. Kjo Rregullore hynë në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen e Komunës së Deçanit.

01.Nr.I-5

Deçan,dt.31.01.2022

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit

Hajdar SUTAJ